

Në bazë të nenit 43, paragrafi 1 i Ligjit për buxhetin dhe vitin fiskal ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi", nr. 20/14 dhe 56/14), nenit 38 dhe 39 të Ligjit për financimin e vetëqeverisjes lokale ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi", nr. 03/19), nenit 58 dhe 110 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi – dispozitat e komunës", nr. 48/2019), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më ____ ____ 2020 ka nxjerrë

VENDIMIN për kriteret më të përafërta për shfrytëzimin e mjeteve vijuese dhe të përhershme të rezervës buxhetore

Neni 1

Me këtë Vendim konfirmohen kriteret më të përafërta për shfrytëzimin e mjeteve vijuese dhe të përhershme të rezervës buxhetore.

Neni 2

Mjetet vijuese të rezervës buxhetore shfrytëzohen për shpenzimet e paparashikuara ose jo të parashikuara mjaftueshëm që financohen nga Buxheti i Komunës dhe atë për:

1. Sigurimi i mjeteve që mungojnë për financimin e veprimtarisë së rregullt të njësive shpenzuese;
2. Ndhimë për personat fizikë me gjendje të keqe materiale për:
 - shërim (kurim),
 - shkollim,
 - përmirësimin e situatës materiale;
3. Për qëllime të tjera në përputhje me Ligjin.

Neni 3

Mjetet e rezervës rrjedhëse buxhetore për të ndihmuar personat fizikë në dituatë të keqe materiale mund të shfrytëzohen në shumat si vijon dhe atë:

- për kurim në lartësinë prej 10 vlerave logaritëse të koeficientit të shumës bruto në Komunën e Ulqinit,
- për shkollim në lartësinë prej 5 vlerave logaritëse të koeficientit të shumës bruto në Komunën e Ulqinit,
- për përmirësimin e gjendjes materiale në lartësinë prej 4 vlerave logaritëse të koeficientit të shumës bruto në Komunën e Ulqinit.

Për shfrytëzimin e mjeteve nga paragrafi 1 i këtij neni, kërkesa me dokumentacionin e nevojshëm i parashtrohet Kryetarit të Komunës.

Dokumentacionin e nevojshëm nga paragrafi 2 i këtij neni e përbëjnë:

- dëshmia që personi e ka gjendjen materiale të keqe,
- raporti i mjekut për nevojën e kurimit të mëtejshëm në rastin e ndihmës për shrim,
- dëshminë që personi i plotëson kushtet për t'u regjistruar në institucionin arsimor, në rastin e ndihmës për shkollim.

Neni 4

Shfrytëzuesëve të mjeteve të rezervës vijuese buxhetore nga neni 3 i këtij Vendimi mund t'u miratohen mjetet vetëm një herë gjatë vitit fiskal deri në shumën e paraparë me këtë Vendim.

Përrjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni. Kryetari i Komunës mund të miratojë shfrytëzimin e mjeteve të rezervës vijuese buxhetore me kërkesën e shfrytëzuesit të cilit i janë të arsyeshme arsyet për ndarjen e sërishme të mjeteve.

Neni 5

Mjetet e rezervës vijuese buxhetore nga neni 2, pika 3 të këtij Vendimi shfrytëzohen për pjesëmarrje dhe sigurimin e kushteve dhe avancimin e veprimtarive: mbrojtjes shëndetësore, arsimimit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve dhe fushave të tjera me interes për komunitetin lokal.

REZERVAT E PËRHERSHME BUXHETORE

Neni 6

Mjetet e rezervës së përhershme buxhetore mund të shfrytëzohen edhe për mbulimin e shpenzimeve që kanë lindur si mënjanim i pasojave të rrethanave të jashtëzakonshme, (vërshimet, thatësit, tërmeti, epidemia, katastrofat ekologjike, zjarret dhe fatkeqësi të tjera elementare) si dhe për ekzekutimin e përkohshëm të obligimit të buxhetit me rastin e zvogëlimit të vëllimit të të ardhurave dhe mbulimin e deficitit buxhetor. Vendimin për përdorimin e rezervës së përhershme buxhetore e nxjerr Kryetari i Komunës me propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë elementare (natyrore).

Neni 7

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës”.

Numër: _____
Ulqin, më ____ . ____ . 2020

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

kryetari
dr. Ilir Çapuni

ARSYETIM

Baza juridike

Bazën juridike për nxjerrjen e këtij Vendimi e përmban neni 43, paragrafi 1 i Ligjit për buxhet dhe përgjegjësi fiskale ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi", nr. 20/14 dhe 56/14), me të cilin është parashikuar që për shpenzimet e paplanifikuara ose të planifikuara jo mjaftueshëm shfrytëzohen mjetet e rezervës vijuese.

Po ashtu me nenin 38 dhe 39 të Ligjit për financimin e vetëqeverisjes lokale ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi", nr. 03/19), parashikohet që mjetet vijuese të rezervave buxhetore shfrytëzohen për shpenzimet e paplanifikuara ose të planifikuara jo mjaftueshëm gjatë vitit fiskal që financohen nga buxheti, si dhe që me këto mjete disponon Kryetari i Komunës në pajtim me dispozitën e Kuvendit të Komunës.

Arsyet për nxjerrjen e Vendimit

Arsyet për nxjerrjen e këtij Vendimi janë parashikimi i kriterëve më të përafërta për shfrytëzimin e mjeteve rezervë buxhetore.

Arsyetimi i zgjidhjeve konkrete

Me dispozitën e nenit 2 të Vendimit të përmendur është përcaktuar se kush ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve të rezervës vijuese buxhetore.

Me nenin 4 është paraparë që mjetet e rezervës vijuese nga neni 3 mund të shfrytëzohen një herë në vit, si dhe mundësia që Kryetari i Komunës përjashtimisht mund të ndajë edhe me arsyen e arsyetuar.

Po ashtu me nenin 5 është parashikuar që mjetet vijuese të rezervës buxhetore nga neni 2, pika 3 mund t'i shfrytëzohen për sigurimin e kushteve për avancimin e mbrojtjes shëndetësore, arsimimi, mbrojtja sociale dhe e fëmijëve dhe origjimeve të tjera me interes për komunitetin lokal.

Me nenin 6 janë parashikuar kushtet e shfrytëzimit të rezervës së përhershme buxhetore, si dhe që Kuvendi i Komunës nxjerr Vendimin për shfrytëzimin e saj, me propozim të Komisionit për vlerësimin e dëmit nga fatkeqësitë natyrore.

Me nenin 7 është paraparë që ky Vendim hynë në ditën e tetë pas botimit në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

SEKRETARIATI PËR FINANCA DHE BUXHET